

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN “PËR PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE QË RIORGANIZOHEN SIPAS LIGJIT PËR INSPEKTIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i institucioneve që do t'i nënshtrohen procesit të riorganizimit, sipas përcaktimeve në pikën 3, të nenit 3, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi kryesor është eliminimi i mbivendosjes së kompetencave institucionale dhe inspektuese, reduktimi i numrit të inspektorateve dhe rritja e eficiencës së inspektimeve. Riorganizimi synon uljen e numrit të inspektimeve dhe eliminimin e pengesave dhe kostove abuzive ndaj biznesit. Qëllimi i riorganizimit konsiston në përmirësimin e klimës së biznesit, reduktimin e procedurave inspektuese ndaj biznesit dhe uljen e kostove të administratës publike ndaj biznesit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi “Për përcaktimin e institucioneve që riorganizohen sipas ligjit për inspektimin” është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Qëllimi i këtij projektvendimi lidhet me një nga qëllimet prioritare të ligjit për inspektimin mbi uljen e barrës administrative ndaj biznesit, nëpërmjet riorganizimit të inspektorateve dhe institucioneve me funksione inspektimi në fushë zbatimin e ligjit për inspektimin, në bazë të fushave të lidhura me risqet e ngjashme. Problematikat e vazhdueshme mbi përplasjet dhe mbivendosjet e kompetencave institucionale për shkak të ushtrimit të funksioneve të njëjta apo të ngjashme inspektuese sjell si nevojë të domosdoshme riorganizimin e tyre, duke bashkuar në struktura të vetme inspektuese institucionet/strukturat që kanë funksione të ngjashme inspektimi. Ky riorganizim synon krijimin e institucioneve/strukturave të pastra inspektuese, duke ndarë inspektimin nga funksione të tjera institucionale të ndryshme me inspektimin, problematikë e cila është evidentuar që përpara hartimit të ligjit për inspektimin, ku i njëjti institucion që licencon edhe inspekton.

Zbatimi i projektvendimit për riorganizimin e inspektorateve synon uljen e numrit të inspektimeve në subjektet e inspektimit, e cila sjell edhe uljen e barrës administrative si ulje e kostos në kohë/orë

inspektimi pranë bizneseve, rritjen cilësore të procedurës së inspektimit, rritjen e konkurrueshmërisë dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Inspektimet e realizuara me trupa inspektuese të përbashkëta do të sjellin ulje jo vetëm të kostos në kohë/orë inspektimi pranë bizneseve, por edhe të kostos në përdorimin e burimeve publike. Për rrjedhojë, pritet që numri i inspektimeve të ulet ndjeshëm. Koha e qëndrimit në subjektin e inspektimit gjatë një viti kalendarik, për shkak të bashkërendimit të fushave të inspektimit, pritet të reduktohet ndjeshëm. Efektet e pritshme lidhen me ushtrimin e funksioneve administrative më me eficiencë, në kohë dhe cilësi nga riorganizimi i veprimtarive inspektuese.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar mbështetet në nenin 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 3, të nenit 3, të ligjit nr.99/2024, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu, ky projektakt nuk përbën një akt nënligjor që sjell përfitime shtesë për subjektet e përfshira dhe, për pasojë, nuk bie ndesh me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimin përkatës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky vlerësim mbështetet në sqarimet e dhëna në shkresën zyrtare të KQZ-së, nr. prot. 1546, datë 03.03.2025, mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, si dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përmban 3 pika, si më poshtë:

Pika 1 përcakton institucionet në nivel qendror, në fushën e zbatimit të ligjit për inspektimin, të cilat i nënshtrohen procesit të riorganizimit.

Pika 2 përcakton institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi.

Pika 3 parashikon hyrjen në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e projektvendimit ngarkohen për zbatim:

1. Kryeministria;

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
4. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
5. Ministria e Arsimit dhe Sportit;
6. Ministria e Brendshme;
7. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
8. Ministria e Financave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Inspektorati Qendror (në proces ristrukturimi si Inspektorati i Përgjithshëm), në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Gjatë procesit të përgatitjes, projektakti është konsultuar paraprakisht me Ministrinë e Drejtësisë.

Ky bashkëpunim është zhvilluar në zbatim të Urdhrit nr. 49, datë 26.03.2025, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit drejtues ndërinstytucional të punës dhe grupeve teknike ndërinstytucionale për riorganizimin dhe ristrukturimin e inspektorateve në Republikën e Shqipërisë, për hartimin e projekteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit për inspektimin, si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit elektronik të inspektimeve 'e-Inspektimi'".

Projektvendimi do të dërgohet për mendim në:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;
- Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;
- Ministrinë e Brendshme;
- Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrinë e Financave;
- Ministrinë e Drejtësisë;
- Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin;
- Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor;
- Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Përfitim ekonomik nga procesi i riorganizimit të institucioneve nuk parashikohet të ketë, për arsye se numri i punonjësve të këtyre institucioneve/strukturave nuk do të ndryshojë. Përfitimi ekonomik do të jetë për biznesin nga procesi i ristrukturimit dhe riorganizimit, duke reduktuar numrin e institucioneve dhe strukturave që ushtrojnë funksione inspektuese.

Projektvendimi nuk shoqërohet me kosto financiare për buxhetin.

PROPOZUESI

MINISTRI I SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT

DELINA IBRAHIMAJ

